

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

EDELAJDA CENAJ - ÇEPA

LETËRKËMBIMI I LEF NOSIT

Në fondin *Lef Nosi* në AQSH numërohen rreth 400 korrespondenca të Nosit me veprimtarë e atdhetarë të kohës, miq e familjarë, ku përfshihen edhe korrespondenca mes personash të tretë ku emri i Nosit përmendet në to. Tek ditari hasemi me një gjuhë më të thjeshtë, mënyrë të shprehuri telegrafike pa përfshirë shumë emocione në shkrim. Një tjetër tablo shfaqet nëse kalon përmes letrave të dërguara prej Lef Nosit, veçanërisht atyre me natyrë personale. Këto letra përvijohen prej shprehjes së përjetimeve vetjake, larmisë së ndjesive, artikulimit të mendimeve në një formë ndryshe, ku gërshetohen emocione njerëzore, malli, përkujdesja, afeksioni etj., me logjikën e ftohtë të intelektualit.

I dashuni Sif

U gëzova shumë kur mora vesht nga lettra jote se paske muftun me e bindun tët atë për me të lirimë qi të pasojsh mësimet e tua edhe se ndodhesh aty. Kam shpresë se do t'i mundish gjithni pengimet qi të çfaqen nga yt atë e do t'ia arrijshë qëllimit. Asht e ditun se shkaku i kundërshtimit t'it nuk vjen aqë nga punët e shuma qi ka e të do përdame sa vjen nga mosçmimi i ditunis. ...

Po të jetë qi të epesh pak pas Englishtes mund t'i bajsh mësimet e nalta në London...

Tyke u lutun të gjejë lettra shëndoshë mbetem i dashuni yt ungj¹.

E dashuna ime-ma.

Lettrën tande nga Durrësi me anë të Mustës e mora edhe u gëzova qi jeni shëndoshë. Edhe ma tepër jam gëzumë për martesën e Sanës, lindjen e djalit t'Kolës, ardhjen e Sifit edhe qenjen e nuses s'Grigorit ma mirë. Besoj se edhe Venemini është kthymë shëndoshë nga Durrësi. Njiditë thirra edhe Mitrin e Sildastit më telegrafore të Fierit e pyeta për ju.

...

Nusja e Kolës përintët i ka mirë edhe u gëzuan për lindjen e djalit. Emnin t'ia ngjitni shqip. Gjithve u falem me shëndet. Të vegjëlvat u puth sytë. Sifit veçan i puthë sytë.

Tyke të puthun dorën mbetem,

Biri i yt, Lefi².

I dashuni vlla Grigor.

Kartën tate ato të Kolës edhe të Ali Irfanit i mora edhe u gëzova qi jeni shëndoshë. Edhe ne jemi shëndoshë e së gjithash mirë. Presim me sot e me nesër qi të marrë funt puna e të vimë aty.

Farës e fisit u falem me shëndet³.

¹ Pjesë të një letre dërguar prej Lef Nosit nga burgu i Bruzës në Turqi nipit të tij më 25.1.1911 (AQSH, Fondi 32, *Lef Nosi*, Dosja nr. 58).

² Pjesë nga një letër e Lef Nosit dërguar nënës së tij më 21 shkurt 1913. AQSH, Fondi 32, *Lef Nosi*, Dosja nr. 58.

Parimisht letërkëmbimi mund të klasifikohet si letërsi publicistike. Letrat e dërguara prej Nosit përshkohen në masë nga elementi artistik si tejçues i ndjesive dhe përjetimeve personale të shkruarit. Kjo i jep atyre natyrë edhe më letrare. Artikulimi i fjalës dhe frazës duket se ka pasur vëmendje të veçantë prej shkruarit duke e bërë tekstin të pasur me elementë leksikorë e artistikë. Këtë prirje Nosi e shfaq edhe në ato raste kur ngurtësia dhe ftohtësia e pozicioneve dhe detyrave zyrtare e shtetërore nuk lenë shteg për një komunikim tej atij strikt-formal. Por me natyrën e tij Nosi i kapërcente këto kufij duke mbivendosur njerëzoren, emocionalen, shpirtëroren edhe aty ku një praktikë a një tërësi rregullash të kodifikuar mund ta quanin këtë të papërputhshme, të papranueshme apo edhe të qortueshme. P.sh. një sintezë e qartë e kësaj prirjeje të Lef Nosit është një letër që ai nga pozicioni i ministrit të postë-telegrafit ia dërgonte nëpunësve të postës në të gjithë Shqipërinë me rastin e njëvjektorit të shpalljes së pavarësisë së vendit:

Dita e sotme e indipendencës tonë kombëtare të cilën të huajët na e kishin grabitun që nga sot pes qind vjet asht ma e shenjta e ma e lumëta ditë për gjithë kombin Shqiptar. Sot stërgjyshënit tonë që derdhën gjakun pa kursim për të mos e humbun atë, çojnë kryet nga varret edhe marrin pjesë në këtë kremtim të ngazëllushëm, edhe vllazënit tonë që mbetën ndën zgjedhën e armiqvet, kremtojnë me zëmër bashkë me ne tyke prituri që sot mot mot të jenë bashkuar me mamën Shqipënie. Tyke i lutun Zotit që të mbushi gjith shpresat e dëshirat tona ju uroj për mot e gëzuar ditën e sotme.

*Lef Nosi*⁴

Prej Lef Nosit janë shkruar e dërguar një numër i madh letrash zyrtare të cilat përcjellin informacion të bollshëm dhe të patjetërsueshëm mbi vetë Nosin, personazhe, institucione, organizma shtetërore ose jo, klimës dhe atmosferës politike e sociale duke i bërë një burim të pazëvendësueshëm informacioni. Edhe në letrat personale shpesh herë Lef Nosi gjen vend të trajtojë çështje politike ose japë informacion mbi to.

Normaleja, shkolla e Korçës edhe gazetat shqipe me gjithë shtyshkronjat janë pa hapë se urdhëni që u dha që fallco ngaqi sundimtarët e vendit nuk lanë të hapet. Asht e ditun që janë dy lloj urdhnash: njani zyrtarë edhe tjetri tinzarë. Gurakuqi pas lajmevet që kam nga Stambolli pritët të vijë aty me gjithë Dervish benë.

*Në Manastirë po përpiqen të hapin shtyshkronjat me tjetër emën e të qisin një gazetë me emnin "Drita"*⁵.

*

* *

³ Pjesë të një letre dërguar prej Lef Nosit vëllait të tij Grigorit më 12 mars 1913. AQSH, Fondi 32, *Lef Nosi*, Dosja nr. 58.

⁴ Kjo është një letër dërguar më 28 nëntor 1913 prej Lef Nosit nëpunësve të të gjitha zyrave postare e telegrafike të Shqipërisë, me rastin e njëvjektorit të shpalljes së pavarësisë së vendit. AQSH, Fondi 32, *Lef Nosi*, Dosja nr. 54.

⁵ Pjesë nga letra personale dërguar nipit Sif, më 25 janar 1911. AQSH, Fondi 32, *Lef Nosi*, Dosja nr. 58.

Letërkëmbimi i Lef Nosit

Punët e Shqipnis qen tyke mar funt shpejt; po ra e s'u ndreq Turqia me Bullgarinë për punë t'Edrenes se (?) rrëzoi kabinetin e Qamil Pashës e vrau ministrin e luftës Nazim pashën e si e rroku frenin e mbretëris në dorë nisi prap luftën. Për fat të mirë ushtria e turqvet u kthye prap e pritët këtë javë të mbyllet paqë.

Për kufijt e Shqipnis hahesh Rusia me Austrinë aqë shumë sa qi desh të nisin luftë, po lajmet e fundit na kalxojn se u ndreqën edhe po i lëshojnë ushtritë që patën mbledhë. Besoj se nuk asht për tu vonum ma puna e për së shpejti do të vimë në Elbasan në kryeqytetin e pastajshëm të Shqipnis së re.

... ..

P. S. Si duket Shqipëria do të humbasë vetëm Prishtinën, Mitrovicën, Gjilanin, Preshevën, Kaçanikun, Ferizovikun, Kumanovën, Plavën e Gucinë edhe të shumë Janinën, për të cilën më tjetër anë kemi lajme të sigurta qi duan t'ia lanë Shqipnis. Këtë javë Kongresi i Londrës po bisedon çështjen e kufivet edhe vendimi do të botohet. Po duhet të dimë se kjo punë u vendos ma përpara ndërmjet Austrisë e Rusisë e pasandaj u vu në bisedën e Kongresit⁶.



Një nga letrat e dërguara prej Lef Nosit

⁶ Pjesë nga letra personale dërguar nënës së tij. (AQSH, Fondi 32 (Lef Nosi), Dosja nr. 58).

Emocioni dhe ndjenjat përshkojnë si një fill përbashkues letrat e shkruara prej Nosit. Ai i qendërzon ato në fraza të ndërtuara artistikisht, me fjalë të përzgjedhura e që përcjellin tek receptuesi zërin e brendshëm dhe artin e fjalës. A nuk është një nga funksionet e letërsisë transmetimi i emocionit? *Një ndër proceset e që individin e çdo kohe e bënë të provojë qoftë dhe për pak çaste rolin e shkrimtarit është ai i shkrimit të letrës*⁷. Frazat e mëposhtme në strukturën e letrave të Nosit mbajnë dhe përçojnë ngarkesë emocionale pozitive, por njëherazi ato marrin vlerë të shtuar duke i bashkangjitur kontekstin e letrës, së kohës së shkruesit, rrethanat sociale në të cilat gjendej shpesh Nosi. Njëkohësisht do të mund të shërbenin fare mirë si formula popullore urimi, si burim për këto apo si ekstrakt i të njëjtave.

Tyke u lutun të gjejë letra shëndoshë mbetem i dashuni yt ungj.

E dashuna ime-ma.

Emnin t'ia ngjitni shqip.

Gjithve u falem me shëndet.

Të vegjëlvet u puth sytë. Sifit veçan i puthë sytë.

Tyke të puthun dorën mbetem biri i yt Lefi.

Farës e fisit u falem me shëndet.

Tyke i lutun Zotit qi të mbushi gjith shpresat e dëshirat tona ju uroj përmot e gëzuar ditën e sotme.

⁷ L. Smaqi, *Itinerare që ndërthuren*, Tiranë 2012, f. 143.